

VENDIM
Nr. 962 , datë 2.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 144, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT “LUSHNJË-BERAT (LOTI 1, 2, 3 DHE
OBJEKTET)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 144, datë 18.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall”, “ullishte (tokë bujqësore)”, “objekte” dhe “drufrutorë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 95 728 711 (nëntëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë, nga të cilat:

a) për “arë”, “truall”, “ullishte (tokë bujqësore)”, me sipërfaqe shpronësimi 189 744 m², në vlerën 67 912 764 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë;

b) për “objekte”, në vlerën 27 280 947 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë;

c) për “drufrutorë”, në vlerën 535 000 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë tokë “arë”, “truall”, “ullishte (tokë bujqësore)”, “objekte” dhe “drufrutorë”, prej 95 728 711 (nëntëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, zëri “Shpronësimet”.

b) Të dhënat për pasurinë nr. 22/9, zona kadastrale 1098, në pronësi të z. Pëllumb Çela, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën që bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale shtesë, sipas këtij vendimi, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 144, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT “LUSHNJË–BERAT (LOTI 1, 2, 3 DHE OBJEKTEI)”

Nr. rendor në VKM-në 144/2015	Emri i pronarit	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. e shpronësuar (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera për “tokën arë”	Vlera e kulturave bujqësore	Vlera totale (lek)	Shënime
347	Pëllumb Çela	1098	22/9	arë	5,642	666	502	334,332	535,000	869,332	Konfirmim, AREB Lushnjë, me shkresë nr. 73/1, datë 5.3.2019
VLERA TOTALE (LEK)										869,332	